



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:218388

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05408420

P.nr.1349/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm Penal- gjyqtari Lulzim Hoxha, me bashkëpunëtoren profesionale Afërdita Kicaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve: A. (S.) B., nga Fushë Kosovë rr. “Nëna Terez”, F. (Xh.) F.; nga fshati Peqan, Komuna e Suharekës për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nr.04/L-082 sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.1791-7/21 të datës 29.09.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren Mehreme Hoxha, të akuzuarit A. B., dhe F. F.;, me mbrojtësin av. S.F., me datë 29.02.2024, publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 04.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

A. B., nga i ati S., dhe e ëma, e lindur, i lindur me datënnë Suharekë, me banim në Fushë Kosovë rr. “.....”, i pa martuar, ka të kryer tetë vjetë të shkollës fillore, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikë së Kosovës, i identifikuar në bazë të numrit personal:

F. F.; nga i ati Xh., dhe e ëma, e lindur, i lindur me datënnë Suharekë, me banim në fshatin Peqan Komuna e Suharekës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikë së Kosovës, i identifikuar në bazë të numrit personal:

JANË FAJTORË

Se me datën 10.03.2021, rreth orës 19:15 minuta, në rrugën “Fehmi Lladrovci”, në Prizren, saktësisht në lokalin me mbishkrimin “.....”, të pandehurit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetre, ia merr pasurin e luajtshëm të dëmtuarit Y.H.;, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte në shtëpinë e tij përmes telefonit njoftohet nga punëtorja e tij, se një person i pa njohur i dyshimtë po sillej në market, i dëmtuari shkon në market, ku përmes kamerave të sigurisë vëren se të pandehurit A. B., F. F.; dhe Sh.F., ditën kritike me datë 10.03.2021 duke marr çokolata “ ” si dhe çamçakëz “orbita”, me atë rast vërejnë se të njëjtit edhe me datën 26.02.2021, kishin vepruar njëjtë derisa marrin nga raftet e marketit çokolata, orbita, gjithsej në vlerë prej 225 euro, dhe largohen nga vendi i ngjarje.

Me këto veprime në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së nr. 04/L-082.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 4, 7, 8, 9,17, 31,41, 42, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 55, 73, 74, 75,76, të KPRK-së, si dhe nenit 364 KPPRK-së,

Të akuzuarve iu shqipton :

DËNIM ME GJOBË

- Të akuzuarin A. B., në shumën prej katërqind (400,00) €, për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, të cilin dënim me gjobë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Të akuzuarin F. F.; në shumën prej katërqind (400,00) €, për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, të cilin dënim me gjobë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse të akuzuarit A. B., dhe F. F.; nuk mund apo nuk dëshirojnë ta paguajë dënimin me gjobë në shumën e lartcekur, atëherë gjykata konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € llogaritet 1 (një) ditë burgim, gjithsej për secilin veç e veç me nga 20 ditë burgim.

Si dhe:

DËNIMIN ME KUSHT

- Të akuzuarin A. B., duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej dy (2) viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
- Të akuzuarin F. F.; duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej dy (2) viteve nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
- Në qoftë se të akuzuarit gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet i njëjti do të revokohet.
- I dëmtuari me adresë si në shkresat e lëndës për realizimi e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil-juridik.
- OBLIGOHEN të akuzuarit A. B., dhe F. F.; që ti kompensoj shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet, kurse në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguajnë shumën prej (20) njëzet euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej (20) njëzet euro, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.

- Urdhërohet Shërbimi Sprovues i Kosovës - dega në Prizren, që të bëjë mbikëqyrjen e dënimit me kusht

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Penal, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr. 1791-7/21 të datës 29.09.2021, kundër të akuzuarve: A. (S.) B., nga Fushë Kosovë rr. “.....”, F. (Xh.) F.; nga fshati Peqan, Komuna e Suharekës për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, nr.04/L-082.

Duke vepruar në këtë çështje penale, gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar më datë 29.02.2024, në të cilin të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së lartcekur.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe konform dispozitave të nenit 241 e 242 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Të akuzuarit deklarojnë se: e ka të qartë aktakuzën dhe e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës.

Prokurori i shtetit deklaroi se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë.

Palët heqën dorë nga seanca mbi caktimin e dënimit.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata në shqyrtim fillestar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datën 10.03.2021, rreth orës 19:15 minuta, në rrugën “Fehmi Lladrovci”, në Prizren, saktësisht në lokalim me mbishkrimin “.....”, të pandehurit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo personin tjetër, ia merr pasurin e luajtshëm të dëmtuarit Y.H., , në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte në shtëpinë e tij përmes telefonit njoftohet nga punëtorja e tij, se një person i pa njohur i dyshimtë po sillet në market, i dëmtuari shkon në market, ku përmes kamerave të sigurisë vëren se të pandehurit A. B., F. F.; dhe Sh.F.; ditën kritike me datë 10.03.2021 duke marrë çokolata “.....” si dhe çamçakëz “orbita”, me atë rast vërejnë se të njëjtit edhe me datën 26.02.2021, kishin vepruar njëjtë derisa marrin nga raftet e marketit çokolata, orbita, gjithsej në vlerë prej 225 euro, dhe largohen nga vendi i ngjarje.

Me këto veprime në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: vjedhja nga neni 325 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së nr. 04/L-082.

Gjykata, gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë prej të akuzuarve, të cilët në seancën e shqyrtimit fillestar vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë, andaj gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas nenit 251 të KPPK-së.

Gjithashtu, në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Kësisoj, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 240 lidhur me neni 242, dhe se në veprimet e të akuzuarve A. B.,t dhe F. F., formohen të gjitha elementet e veprës penale: vjedhja nga neni 325 par.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-së nr. 04/L-082 dhe për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprkishtë duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 73, 74, 75,76 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris veprime të tilla kundërligjore. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë, veprën penale të kryer, niveli i dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyrën e kryerjes së veprës penale, shkallën e lartë të dashjes, të njëjtit janë recidivist të veprave penale të kësaj natyre, veprimi me përgjegjësi, ku të akuzuari me dashje me qëllim të përfitimit të pasurisë për vete apo personave të tjerë, hynë në lokalitet me mbishkrimin “.....”, dhe nga aty marrin çokolata “Milka” si dhe çamçakëz “orbita”, me atë rast vërejnë se të njëjtit edhe me datën 26.02.2021, kishin vepruar njëjtë derisa marrin nga raftet e marketit çokolata, orbita, gjithsej në vlerë prej 225 euro, andaj gjykata konsideron se me këtë masë sanksionuese do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla kundërligjore.

Gjykata vendimin e ka mbështetur duke u bazuar edhe në neni 38 i KPK-së i cili konsiston në *“parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcim detyrimit për respektimin e ligjit”*.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).
- Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 462 par. 1. dhe 2. të KPPK-së.
- Vendimi mbi kompensimin e viktimave të Krimit, gjykata e mori në kuptim të nenit 36 parag.3 pika 3.1 të Ligjit me numër 08/L-109. ku thuhet *“për veprën penale që gjykohet*

në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore shuma është prej njëzet (20) Euro”.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 1349/23, të datës 03.04.2024

B. Profesionale,
Afërdita Kicaj

Gjyqtari,
Lulzim Hoxha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga dita e pranimit të të njëjtit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kësaj gjykate.